



RAPORT MONITORIMI

Arsimi

Nëntor 2020 -Janar 2021



AUTOR

Migen Qiraxhi

QENDRESA
QYTETARE



National Endowment
for Democracy
Supporting Freedom Societies the World

www.qeverisja.qq.com.al

1. Arsimi – I fundit në listën e prioriteteve të Qeverisë

Pas kalimit të një semestri të plotë nëpërmjet mësimit online, studentët e universiteteve publike dhe private prisnin të fillonin mësim në auditore, ashtu siç kishte paralajmëruar konferenca e Rektorëve dhe Ministria e Arsimit në muajin tetor 2020.

Katër ditë para fillimit të procesit mësimor, në datën 30 tetor 2020, Komiteti Teknik i Ekspertëve të pandemisë covid-19 doli me një vendim duke sugjeruar që universitetet të zhvillojnë mësimin online si masë anti-covid. Organet drejtuese të universiteteve të gjendura të papërgatitura dhe të pa konsultuara me këtë vendim, ligjëruan sugjerimin e Komitetit dhe në datën 2 nëntor zyrtarisht nisi mësimi vetëm online në të gjitha universitetet publike dhe private.



Kjo situatë e gjeti të papërgatitur edhe komunitetin e studentëve të cilët, bazuar në njoftimet e MASR dhe Rektorëve kishin marrë të gjitha masat për fillimin e mësimit të alternuar duke

paguar tarifat e konvikteve, shtëpive me qera dhe orendive të nevojshme për jetën e tyre studentore në bashkitë universitare. Java e parë e mësimit nisi me protesta të studentëve të cilët kundërshtuan zhvillimin e mësimit online duke e cilësuar si jo efektiv, nisur edhe nga eksperiencia e tyre në muajt mars – gusht 2020. Studentët protestuan edhe për shkak se të gjitha aktivitetet si mbledhjet e partive, pishinat, kinematë, bar kafet dhe restorantet ishin të hapura dhe vetëm universitetet të mbyllura duke akuzuar qeverinë se nuk e ka arsimin e lartë në fokus të saj.

Ky ishte një konstatim i drejtë pasi Komiteti Teknik i Ekspertëve nuk bëri asnjë vlerësim apo studim për këtë vendimmarrje për të konstatuar se

vetëm universitetet ishin vatra infeksione dhe aktivitetet e tjera jo. Përvec kësaj në pjesën përbërëse të këtij komiteti nuk pati ekspertë ose njohës të arsimit të cilët mund të orientonin universitetet se si duhet ti qaseshin masave të pandemisë covid 19.



Nga ana tjetër në periudhën nëntor – janar janë vërejtur e denoncuar me dhjetra aktivitete të organizuara nga forcat politike kryesore në vend ku vihet re mosrespektimi i masave, ambientet e vogal dhe të mbyllura të cilat nuk i ngjajnë aspak universiteteve duke hedhur hije dyshimi në vendimarrjen e komitetit teknik të ekspertëve të pandemisë, ku edhe vetë kryetarja e këtij institucioni u fotografua në një mbledhje partie që thyente rregullat e vendosura nga vetë komiteti.

2. Mësimi online – Sfida e të rinjve nga celulari

Një nga sfidat kryesore të mësimin në distancë, për arsye të ndryshme ka qënë edhe aksesin e vazhdueshëm të studentëve në mësimin online. Bazuar në vlerësimin e Qëndresës Qytetare vetëm 60% e studentëve të pyetur kanë ndjekur rregullisht mësimin online ndërsa 40% e tyre nuk



kanë pasur mundësi të ndjekin mësimin në distancë rregullisht.¹ Për shumicën e studentëve arsyt kryesore që i kanë penguar për të ndjekur mësimin ka qënë mungesa e aksesit në internet, pajisjet digjitale dhe mungesa e platformave adekuate për mësimin online.

Nisur nga nevojat dhe specifikat që ka realizimi i mësimin në distancë, një nga sfidat kryesore

përveç aksesit në internet është pajisja me infrastrukturë digjitale të përshtatshme e stafeve akademike dhe studentëve. Sipas të dhënave të sondazhit, 77.5% e studentëve e ndjekin mësimin online nëpërmjet telefonit celular. Aparati celular ofron mundësi të pakta për të aksesuar dokumenta në microsoft office dhe për të ndërvepruar me detyra kursi, mund të themi që pjesa më e madhe e studentëve janë të kufizuar në pjesëmarrje cilësore në mësimin online.



Përveç kësaj tashmë që afron edhe sezon ii provimeve, të cilat sipas udhëzimeve nga universitetet do të realizohen online, cilësia dhe produktiviteti i studentëve në to do të lërë për të dëshiruar. Nga ana tjetër problem mbetet edhe integriteti i provimeve pasi nëpërmjet platformave dhe pajisjeve që kanë në dispozicion stafet akademike e kanë të pamundur të kontrollojnë studentët. Kjo situatë mund të stimulojë kopjet në masë dhe cënimin e meritokracisë. Kjo problematikë bëhet akoma më e rënduar në sistemin e arsimit parauniversitar ku nxënësit,

prindërit dhe mësuesit janë më pak të familjarizuar me internetin dhe përdorimin e pajisjeve digjitale.

¹ <https://qq.com.al/wp-content/uploads/2020/12/Vleresimi-i-mesimit-online-Dhjetor-2020-pdf.pdf>

Referuar kronikave televizive, denoncimeve nga nxënës e prindër, platforma e vënë në dispozicion nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë nuk ofron shërbim cilësor, shpesh herë ka shkëputje, mosfunksionim dhe duhet përdorur programi shtesë zoom meeeting për të zhvilluar një orë mësim. Pavarësisht kësaj qeveria nuk ka marrë asnjë masë për të blerë programin zoom për shkollat, kosto të cilën mësuesit e paguajnë vetë ose përdorin variantin me shkëputje 40 minuta.²³

3. Infrastruktura ligjore dhe teknologjike ndaj mësimin online

Edhe pse prej një viti mësimi online ka vijuar pa ndërprerje nuk është hedhur asnjë hap për ta ligjësuar dhe rregulluar me akte ligjore si formë mësimdhënie e cila nuk është e parashikuar në ligjin 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.⁴ Mungesa e rregullimit ligjor ka sjellë qasje të ndryshme, platforma të ndryshme nga universitete të ndryshme publike dhe private për këtë formë mësimdhënie duke krijuar kaos dhe mungesë standartesh në ofrimin e shërbimit të mësimin.



Së dyti studentët e universiteteve private dhe publike kanë paguar rregullisht tarifën e studimit, pavarësisht se nuk kanë shfrytëzuar ambinetet dhe shërbimet administrative të universiteteve. Megjithë nënshkrimin e disa peticioneve nga mbi 10 000 studentë përsëri universitetet dhe MASR nuk kanë ndërmarrë hapa në këtë drejtim, me përjashtim të Universitetit

² <https://www.akademi.al/>

³ <https://euronews.al/al/aktualitet/2020/12/02/mesimi-online-me-probleme-nxenesit-platforma-akademi-al-nuk-po-funksionon>

⁴ https://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/transparenca/ligji_80_2015_22_07_2015.pdf

Bujqësor të Tiranës, i cili ka reduktuar me 15% tarifat e studimit, për shkak të pandemisë.⁵

Megjithëse nuk ka pasur reduktim të tarifave, universitetet nuk kanë bërë shpenzime të cilat lidhen me përmirësimin e infrastrukturës digjitale, rrjeteve dhe klasave të digjitalizuara për të mudnësuar mesimin në distancë të realizuar nga universiteti dhe jo nga banesat e pedagogëve, duke pasur në dispozicion mjete më profesionale dhe ambient më të përshtatshëm për të realizuar mësimin.

⁵ <https://citizens-channel.com/2020/06/16/peticioni-online-studentet-kerkojne-zerim-te-tarifave-ne-universitetet-publike/>

#QËNDRESË MIRËQEVERISJE



www.qeverisja.qq.com.al

RAPORT MONITORIMI

ARSIMI

Nëntor 2020 -Janar 2021